

VENDIM
Nr. 232, datë 30.3.2016

**PËR FINANCIMIN E KOSTOS SË MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE QË
ZBATOHEN NGA FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT DHE PËR NJË SHITESË NË
BUXHETIN E FSHZH-së PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja “a”, e 4, dhe 8, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e koston së menaxhimit të projekteve të qeverisë shqiptare, që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në një vlerë jo më shumë se 157 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekë, e cila përballohet nga zëri i koston lokale, të miratuar në buxhetin e vitit 2016 për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.
2. Financimin e koston së rishikimit të disa projekteve të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR), që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në vlerën 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, e cila përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama